



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.167/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur.

A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se me datën 09.10.2017 kandidati për kryetar të komunës së Drenasit nga radhët e PDK-sw Ramiz Lladrovci, ka shkelur rregullën zgjedhore 13/2013 nenin 5.2, duke përfshirë fëmijë në një postim publik në faqen e tij publike në facebook gjatë fushatës së realizuar në Drenas, ku në këto foto vërehen fëmijë.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2 fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik PDK, në përgjigje në ankesë të datës 11.10.2017, thekson se nuk e konsiderojn si shkelje nga kandidati për kryetar komune nga radhët e PDK-së pasi qëi njejt i në ka mbajtur tubim në një objekt privat ku ka qenë i ftuar dhe fotot që kanë bërë me disa fëmijë janë anëtarë të të njejtës familje. I njëjti i propozon PZAP-it që ankesa në fjalë ta refuzoj si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se në aktivitetet e kandidatit për kryetar komune në Drenas nga subjekti politik PDK janë përfshirë fëmijët, Paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka asnjë element të fushatës zgjedhore nga postimi i bërë, po ashtu nuk mund të vërtetohet se personat prezent kanë qenë nën moshën 18 vjet.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme parashkrimet se është bërë fushatë zgjedhore me nga ana e kandidatit të subjektit politik PDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.167/2017 më datën 12.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.